



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:101443
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05607461

KPPP.nr.1600/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Shoqëria “MIGROS-Group” Sh.P.K., me NUI:810820771, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson ZJ “BARDHI & PARTNERËT” me seli në Prishtinë, Lagja “Dardania”, rr.”Xhemajl Mustafa, H. 36, Kati 4, nr.16, kundër debitorit Shoqëria “Lakeside AG” SH.P.K., me NUI:811284603, me pronar I.P., me seli në Vërmicë, Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.109/22 të datës 22.04.2022, të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Shoqëria “Lakeside AG” SH.P.K., me NUI:811284603, kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.109/22 i datës 22.04.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.109/22 i datës 22.04.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu.
- III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 2,223.05 euro.
- IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Shoqëria “MIGROS-Group” Sh.P.K., me NUI:810820771, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.109/22 të datës 22.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht fatura me numër 21-PF-1H003-501749 e datës 29.06.2021, fatura me numër 21-PF1H-H003-501753 e datës 29.06.2021, fatura me numër 21-PF1-01-0018385 e datës 02.08.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-502222 e datës 02.08.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-502224 e datës 02.08.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-503482 e datës 08.11.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-503-503685 e datës 22.11.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura shumë prej 2,223.05 €, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e arritjes së borxhit për pagesë e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ndër të tjerash ka theksuar se urdhrin përmbartimor e ka pranuar pa dokumentet përcjellëse mbi bazën e të cilave do të mbështeste propozimin për përmbartim dhe me fatura fiktive, nga të cilat vërehet qartë se faturat nuk i plotësojnë kushtet e përmbartueshmërisë sipas LPP-së. Ka shtuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për tu realizuar kjo procedurë e përmbartimit. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin, dhe propozimi për përmbartim të refuzohet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se kreditori me kohë i ka dorëzuar debitorit dhe në vendin e caktuar duke e njoftuar se afati për përmbartjen e pagesës është 15 ditë nga dorëzimi i faturës, me vërejtjen se në të kundërtën kreditori do jetë i detyruar që borxhin ta kërkoj përmes parashtrimit të propozimit për përmbartim të dhunshëm. Ka shtuar se me propozim ka bashkangjitur shtatë faturat në origjinal, dhe se debitori në prapësim është kontrovers, për faktin se deklaron se propozimin e ka pranuar pa dokumente përcjellëse ndërsa më tej thekson se faturat janë të natyrës fiktive. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu

referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura me numër 21-PF-1H003-501749 e datës 29.06.2021, fatura me numër 21-PF1H-H003-501753 e datës 29.06.2021, fatura me numër 21-PF1-01-0018385 e datës 02.08.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-502222 e datës 02.08.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-502224 e datës 02.08.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-503482 e datës 08.11.2021, fatura me numër 21-PF1-H003-503-503685 e datës 22.11.2021, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht faturat e lartcekur i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt,

gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohej vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1600/22, datë 23.04.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.